

KOMPANIA KOSOVARE PËR FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE SH.A.  
KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY J.S.C.  
KOSOVSKO PREDUZEĆE ZA SNABDEVANJE ELEKTRIČNOM ENERGIJOM D.D.  
**KESCO - SH. A.**

Nr. 04    Dt. 29.01.2025  
HQI

**Ymer Fejzullahu**  
Kryesues i Bordit të ZRrE-së

**Mesut Serhat Dinc**  
Kryeshf Ekzekutiv  
KESCO sh.a.

**Datë: 29.01.2025**

**Lënda: Aplikimi për të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2025**

I nderuar zt. Fejzullahu,


Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU) ka përgatitur Aplikimin për të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2025, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Rregullën për Përcaktimin e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregullën për të Hyrat e FSHU-së).

KESCO mbetet i përkushtuar për bashkëpunim me qëllim që të arrihen konkluzione të përbashkëta të cilat janë në interes të të gjithë pjesëmarrësve në sektorin e energjisë.

Me respekt,




**Mesut Serhat Dinc**  
Kryeshf Ekzekutiv, KESCO sh.a.

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
		Faqe	Faqe 1 prej 12
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Versioni	1.0


**APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE NË VITIN 2025 PËR  
FURNIZUESIN ME SHËRBIM UNIVERSAL**

Janar, 2025

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 2 prej 12
		Versioni	1.0

## Përmbajtja

1.	Hyrje .....	3
2.	Bilanci i energjisë elektrike dhe kostot me shumicë.....	3
3.	Kostot me pakicë.....	6
3.1.	Kostot operative dhe të mirëmbajtjes .....	6
3.2.	Investimet Kapitale të FSHU-së .....	8
4.	Kostot e bartshme .....	10
5.	Përshtatjet dhe Faktori korigjues i të hyrave .....	10
6.	Të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2025.....	12

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 3 prej 12
		Versioni	1.0

## 1. Hyrje

Në përputhje me Shtojcën 3 të Rregullës për Vendosjen e të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU), shkresës zyrtare të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të datës 20 dhjetor 2024 dhe shkresës elektronike të datës 20 janar 2025, KESCO i emëruar si Furnizues i energjisë elektrike me Shërbim Universal, ka përgatitur aplikimin për të hyrat e lejuara maksimale (MAR) për vitin 2025.

Në këtë aplikim janë paraqitur të dhënat e nevojshme për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale, përfshirë kostot e blerjes me shumicë, kostot me pakicë, kostot e bartshme dhe përshtatjet për vitet e mëparshme. Të gjitha kostot e propozuara janë të bazuara në analiza të hollësishme dhe parime rregullative, duke siguruar që ato të jenë të arsyeshme, transparente dhe të domosdoshme për funksionimin e qëndrueshëm të furnizimit me energji elektrike.


Më 25 shtator 2024, Rregullatori hapi procesin e shqyrtimit të vlerave hyrëse dhe shpenzimeve operative për FSHU-në për periudhën 2025-2027, të cilat u vendosen në mbledhjen e parë të vitit 2025 të Bordit të Rregullatorit për Energji, mbajtur më 27 janar 2025. Aplikimi është përshtatur për të qenë në përputhje me parametrat rregullativ të miratuar për periudhën 2025-2027, megjithatë FSHU ka rezervuar të drejtën për të përshtatur kostot lidhur me shpenzimet operative dhe investimet kapitale, si kosto të arsyeshme për ofrimin e shërbimeve standarde për konsumatorët e rregulluar, përcaktuar në nenin 13 të Rregullës për të Hyrat e FSHU.

Aplikimi është strukturuar në kapituj të veçantë, duke adresuar secilën kategori të kostove dhe kërkesave për të hyrat e lejuara maksimale. Çdo kapitull përmban analiza të detajuara dhe justifikime për kostot e propozuara, duke reflektuar nevojat operative dhe zhvillimet më të fundit në sektor. Procesi tarifor është interaktiv ndërmjet ZRRE-së dhe palëve të licencuara të tjera, si rrjedhojë, ky aplikim mund të pësojë përshtatje të mëtejshme me qëllim të reflektimit të kostove të ndërlidhura me operatorët e tjerë të sistemit energjetik.

## 2. Bilanci i energjisë elektrike dhe kostot me shumicë

Furnizuesi me Shërbim Universal, bazuar në të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, çdo vit parashikon konsumin e energjisë elektrike për konsumatorët e tij për vitin e ardhshëm, duke përdorur të dhënat historike të konsumit të energjisë elektrike si dhe komponentët e tjerë që ndikojnë në konsum, siç janë kushtet atmosferike dhe rritja ekonomike (përfshirja e konsumatorëve të rinj, indekset e blerjes së energjisë, GDP, etj).

Për vitin 2025, KESCO në rolin e Furnizuesit me Shërbim Universal ka bërë parashikimin e konsumit të energjisë elektrike të pritshëm dhe për qëllime të aplikimit për të hyrat e lejuara

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 4 prej 12
		Versioni	1.0


maksimale për vitin 2025 ka përdorur të dhënat nga draft bilanci i energjisë elektrike, ku konsumi i parashikuar është 5,070 GWh, siç është prezantuar në tabelën më poshtë:

Niveli i tensionit	GWh
Konsumatorë e kyçur në nivel të tensionit 35 kV	59
Konsumatorë e kyçur në nivel të tensionit 10 kV	500
Konsumatorët komercial 0.4 kV	511
Konsumatorët komercial 0.4 kV / II	816
Konsumatorët e amvisërisë	3,141
Ndriçimi Publik	42
<b>Total konsumi në nivel të shpërndarjes</b>	<b>5,070</b>

Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të pandërprerë me energji elektrike për konsumatorët e rregulluar mbështetet në blerjet vendore si KEK-Gjenerimi dhe Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), si dhe nga importi për të mbuluar çdo mungesë të mundshme të prodhimit vendor. Të dhënat e paraqitura në bilancin e energjisë elektrike, janë thelbësore për përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale për Furnizuesin me Shërbimit Universal dhe çdo devijim i tyre shkakton kosto shtesë për furnizuesin dhe/apo konsumatorët në vitin relevant, prandaj është shumë i rëndësishëm përafrimi i tyre me realitetin, respektivisht përcjellja e trendit historik dhe pritshmërive reale në tregjet vendore dhe ndërkombëtare të energjisë elektrike.

Në draft bilancin e energjisë elektrike për vitin 2025, KEK gjenerimi ka paraqitur një plan të prodhimit vjetor të energjisë elektrike, prej të cilave 4,189 GWh janë alokuar për FSHU dhe i cili shërben si bazë për parashikimin e blerjeve nga importit për konsumin e energjisë elektrike. Bazuar në praktikën e deritanishme, njësitë gjeneruese për shkak të vjetërsisë së tyre, nuk kanë qenë në dispozicion për të ofruar kërkesën e paraparë sipas bilanceve të parashikuara, duke rezultuar vazhdimisht në devijime të konsiderueshme nga planet e prodhimit. Çdo mungesë eventuale nga plani i prodhimit vendor rrit nevojën e zëvendësimit të tij me import dhe respektivisht rrezikon të sjellë implikime të konsiderueshme financiare për shkak të çmimeve shumë më të larta të importit krahasuar me koston e blerjes së energjisë elektrike nga KEK. Përveç devijimit të planit të prodhimit të energjisë elektrike nga ana e njësitë gjeneruese të KEK-ut, gjithashtu mos parashikimi i duhur i çmimeve të importit të energjisë elektrike nga ana e ZRRE-së, përgjatë tremujorit të fundit të vitit 2024 kanë shkaktuar një barrë të madhe financiare për KESCO.

Në vitin 2024, një rritje prej vetëm 3% në parashikimin e importeve ka shkaktuar një rritje disproporcionale prej 21% të kostove të blerjes me shumicë. Në këtë kuptim, është thelbësore që gjatë përcaktimit të të Hyrave të Lejuara Maksimale (HLM), Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) të marrë në konsideratë ndikimin financiar që krijohet nga pasaktësitë në parashikimet e prodhimit vendor dhe nevojën për import.

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 5 prej 12
		Versioni	1.0


Për qëllime të këtij aplikimi ne kemi përdor të dhënat për blerjet e energjisë elektrike konform draft bilancit të energjisë elektrike të pranuar nga KEK gjenerimi me dt. 17 janar 2025. Bazuar në parashikimin e konsumit dhe kapaciteteve të disponueshme orë për orë të prodhimit vendor të parashikuar në këtë draft bilanc, FSHU ka paraparë blerjet e energjisë si në tabelën e mëposhtme:

Bilanci Energjetik 2025	GWh
<b>Blerjet</b>	<b>5,070</b>
<i>KEK Gjenerimi</i>	4,189
<i>Blerjet nga BRE në marrëdhënie kontraktuale me KOSTT</i>	545
<i>Blerjet nga BRE në marrëdhënie kontraktuale me FSHU</i>	17
<i>Importi</i>	318
<b>Konsumi</b>	<b>5,070</b>

Me qëllim të kalkulimit të kostove për blerjet e energjisë elektrike për mbulimin e nevojave të konsumit, FSHU në këtë aplikim ka përdorur çmimin e pandryshuar për gjenerimin vendor. Gjithashtu, në mungesë të informacionit në lidhje me çmimin referent të BRE-ve deri në fazën e aplikimit, në këtë aplikacion është shfrytëzuar çmimi aktual referent për llogaritjen e blerjeve nga BRE-të në marrëdhënie kontraktuale me Operatorin e Tregut, ndërsa për BRE-të në marrëdhënie kontraktuale me FSHU, çmimet janë përditësuar për të pasqyruar kërkesat e operatoreve konform Marrëveshjeve për Shitblerjen në fuqi.

Parashikimet e FSHU-së për blerjet e energjisë elektrike nga importi sipas draft bilancit të energjisë elektrike për vitin 2025 janë 318 GWh me një çmim mesatar të importit të parashikuar prej 158.12 €/MWh, sipas parashikimeve të fundit në tregjet ndërkombëtare, përfshirë edhe kostot e kapaciteteve të nevojshme për sjelljen e energjisë elektrike në vend. Në vitin 2024, KESCO për kapacitetet ndërkufitare ka paguar një çmim mesatar prej 30 €/MW, me një total prej 9.06 milion €, përderisa në vitin 2023 kemi paguar mesatarisht 5 €/MW me një total prej 0.9 milion €, prandaj është e domosdoshme gjatë përcaktimit të çmimit të importit të kalkulohe edhe kostot e pritshme për kapacitetet ndërkufitare.

Që nga fillimi i operimit të tregut të përbashkët të energjisë ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, sigurimi i kapaciteteve për import ka rezultuar një sfidë domethënëse për FSHU-në. Një ndër faktorët kryesorë që pengojnë shfrytëzimin e plotë të mundësive që ofron ALPEX është kërkesa për kolateral të lartë. Mungesa e mundësive të mjaftueshme për sigurimin e kredive në vlera të konsiderueshme, për shkak të kufizimeve në asetet që mund të përdoren si garanci, e bën të vështirë pjesëmarrjen aktive të FSHU-së në këtë bursë. Për më tepër edhe kufizimi komercial i tregtimit në kufirin me Serbinë, kufizon aftësinë e FSHU-së për të diversifikuar burimet e furnizimit dhe për të siguruar energjinë elektrike me kushte më të favorshme, duke e bërë atë të varur nga importet vetëm përmes dy rrugëve të tjera ndërkufitare me kapacitete të kufizuara, si Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi. Kjo situatë, jo vetëm që rrit kostot ndërkufitare në një nivel që shpesh e tejkalon

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 6 prej 12
		Versioni	1.0

edhe çmimin aktual të importit, por edhe në rastet kur sigurohet energjia elektrike, kufizimet në kapacitetet rrezikojnë mundësinë e përmbushjes së kërkesave.

Bazuar në të lartë-thënat dhe në përputhje me nenin 17 të Rregullës për të Hyrat e FSHU-së, kostot totale për mbulimin e konsumit të parashikuar për vitin 2025 janë vlerësuar si 220.02 milion €.

Përshkrimi	GWh	mil€
KEK Gjenerimi	4,189	123.59
Importi	545	50.31
BRE Prodhimi në marrëveshje kontraktuese me KOSTT	17	39.74
BRE Prodhimi në marrëveshje kontraktuese me FSHU	318	0.93
Margjina me pakicë		5.45
<b>Kostot e Blerjes së Energjisë me Shumicë</b>	<b>5,070</b>	<b>220.02</b>

FSHU kërkon që ZRRE të marrë në konsideratë faktorët e lartpërmendur gjatë përcaktimit të të Hyrave të Lejuara Maksimale, duke njohur ndikimin e çmimeve të importit dhe sfidave infrastrukturore në kostot e përgjithshme të furnizimit. Njohja dhe reflektimi i saktë i këtyre elementeve është thelbësore për të garantuar që FSHU të mbulojë të gjitha shpenzimet reale të furnizimit dhe të shmangë ndikimet financiare që rrjedhin nga parashikimet joreale apo nga faktorë të paparashikuar të tregut të energjisë.

### 3. Kostot me pakicë


Kostot e lejuara me pakicë përfshijnë kostot operative dhe të mirëmbajtjes, kostot e korporatës, kostot e zhvlerësimit dhe kostot të cilat janë jashtë kontrollit të FSHU-së. Këto kosto njihen nga Rregullatori si të arsyeshme dhe i mundësojnë Furnizuesit operim të duhur.

#### 3.1. Kostot operative dhe të mirëmbajtjes

Në kompanitë e rregulluara, kostot operative dhe të mirëmbajtjes konsiderohen të arsyeshme nga Rregullatori, pasi që ato janë thelbësore për funksionimin e pandërprerë dhe efikas të shërbimeve të furnizimit me energji elektrike. Këto kosto janë të domosdoshme për të siguruar ofrimin e qëndrueshëm të shërbimeve me cilësi të pranueshme, për të përmbushur pritshmëritë e konsumatorëve, si dhe për respektimin e kornizës rregullative dhe ligjore në fuqi.

Gjatë përcaktimit të parametrave rregullativë, ZRRE ka shqyrtuar edhe nivelet e lejuara të shpenzimeve operative. FSHU, në propozimin për vlerat hyrëse dhe shpenzimeve operative për periudhën 2025-2027, ka parashikuar rritje të kostove operative në mënyrë që të pasqyrojë



	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 7 prej 12
		Versioni	1.0

reflektimin e kostove aktuale, rritjen e inflacionit, kërkesat legjislative, si dhe të reflektojë ndryshimet dhe kërkesat e reja në treg. FSHU ka argumentuar se pagat aktuale janë dukshëm më të ulëta se pagat e sektorit publik dhe privat, duke u bazuar në të dhëna nga Pasqyrat Financiare të të licencuarve të tjerë dhe Enti i Statistikave të Kosovës. Për më tepër kjo e fundit ka argumentuar gjithashtu se rritja e numrit të konsumatorëve ka rritur volumin e punëve, duke krijuar presion shtesë mbi punonjësit. Këta të fundit ndjehen të demotivuar kundrejt mos-reflektimit të pagesës për rritjen e volumit të punës, çfarë ka ndikuar me një fluks të largimeve të punonjësve drejt kompanive të tjera dhe jashtë vendit.


Megjithëse ZRRE ka aprovuar një rritje të pjesshme të kërkesës për rritjen e shpenzimeve operative, kjo mbetet e pamjaftueshme për të reflektuar kërkesën e punëtorëve dhe angazhimin e tyre, e njëkohësisht edhe normalizimin me pagat e njëjta në sektor. Nga analizat e ZRRE-së vërehet se janë marrë parasysh trendet aktuale të rritjes së pagave në vend, e njëjta nuk ka marrë parasysh nivelin e pagës bazë, respektivisht pikë-nisja ka diferencë të lartë, duke lënë kështu vazhdimësi të diskrepancës ndërmjet pagës mesatare në sektorin e energjisë elektrike në vend.

Gjatë vitit 2024, si rezultat i faktorëve të ndryshëm dhe jashtë kontrollit të FSHU-së, siç është rritja e pagës minimale në Kosovë, rritja e kostos së transaksioneve bankare, FSHU ka tejkalluar vlerat e lejuara për shpenzimet operative. Këto kosto të shtuara janë zhvillime të jashtme dhe të pavarura nga veprimet e FSHU-së, prandaj njohja e tyre në të hyrat e lejuara është e drejtë dhe e domosdoshme si në aspektin e kornizës ligjore ashtu edhe për qëndrueshmërinë financiare të kompanisë dhe përmbushjen e misionit të saj. ZRRE, në përputhje me kornizën rregullative dhe praktikën më të mira të rregullimit, duhet të njohë kostot aktuale ashtu siç kanë ndodhur në mënyrë objektive, duke marrë parasysh se tejkalimi i shpenzimeve operative nuk ka qenë nën kontrollin e Furnizuesit. Rregullimi efektiv duhet të reflektojë realitetin ekonomik dhe të sigurojë që furnizimi me energji elektrike të mbetet i qëndrueshëm dhe në përputhje me standardet e cilësisë dhe sigurisë.

Nga perspektiva juridike, njohja e këtyre kostove është e bazuar në parimet e barazisë së trajtimit dhe stabilitetit financiar të kompanive të rregulluara, duke siguruar që përmes rregullimit të drejtë, FSHU të ketë kapacitetin për të investuar në teknologji, rritjen e sigurisë së furnizimit dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve. Përveç argumenteve ekonomike dhe politikave sociale në vend, njohja e këtyre kostove gjithashtu përkrah sigurimin e vendeve të punës, zhvillimin profesional të stafit dhe kontribuimin në qëndrueshmërinë e sektorit të energjisë në Kosovë.

FSHU kërkon nga ZRRE që të rishikojë vlerësimin e saj duke marrë parasysh kostot aktuale dhe kërkesat e reja për vitin 2025, ashtu siç janë argumentuar në detaje në aplikimin për të parametrat rregullativ. Për më tepër, aplikimi i mëtejshëm i faktorëve të efikasitetit, edhe pse jashtë rregullave, përbën një pengesë serioze për mbulimin e plotë të kostove dhe dëmton qëndrueshmërinë



	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 8 prej 12
		Versioni	1.0

financiare të FSHU-së. Është e domosdoshme që të eliminohet ky faktor në vlerësimin e kërkesës për paga, duke reflektuar në mënyrë të drejtë dhe të saktë koston reale të shërbimeve të ofruara.


Pa njohjen e plotë të kërkesës për rritje të pagave sipas kërkesës së FSHU-së, operimi normal dhe funksional i furnizuesit vihet në rrezik, duke ndikuar negativisht në performancën e shërbimeve ndaj konsumatorëve dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore. Për më tepër, digjitalizimi i shërbimeve kërkon investime të konsiderueshme dhe kohë për zbatim, ndërkohë që këto kosto ende nuk janë reflektuar në të hyrat e lejuara.

FSHU kërkon nga ZRRE të rishikoj edhe një herë vlerësimin e saj, duke marrë parasysh kostot aktuale të ndodhura gjatë vitit 2024 dhe të reflektoj kërkesat e reja të FSHU-së në vlerësimin përfundimtar të kostove operative dhe të mirëmbajtjes për vitin 2025. FSHU rithekson se kostot e kërkuara janë thelbësore dhe të domosdoshme për të siguruar një operim të qëndrueshëm dhe funksional, duke garantuar përmbushjen e standardeve të larta të cilësisë dhe sigurisë për vitet e ardhshme. Për më tepër, furnizuesi beson se njohja e këtyre kostove është e bazuar ligjërisht dhe në përputhje me parimet e rregullimit të drejtë dhe të qëndrueshëm, duke siguruar që FSHU të ketë kapacitetin e nevojshëm për të përmbushur misionin e tij operativ si shërbyes universal.

### 3.2. Investimet Kapitale të FSHU-së

Investimet kapitale janë thelbësore për zhvillimin dhe modernizimin e operacioneve të Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU). Për të përballuar sfidat aktuale dhe për të ofruar shërbime cilësore, nevojitet implementimi i teknologjive bashkëkohore dhe rehabilitimi i infrastrukturës ekzistuese. Sipas Rregullës për të Hyrat e FSHU-së, kostot e zhvlerësimit që ndërlidhen me investimet kapitale të FSHU-së janë pjesë e kostove të lejuara me pakicë. Gjatë propozimit për vlerat hyrëse dhe shpenzimet operative për periudhën 2025-2027, FSHU ka paraqitur kërkesën për investimet e nevojshme për këtë periudhë rregullative, mirëpo ZRRE nuk e ka trajtuar këtë kërkesë. Ky dokument paraqet arsyetimin dhe përfitimet e këtyre investimeve, duke u fokusuar në avantazhet për konsumatorët dhe ndikimin afatgjatë në operacionet e kompanisë.

Furnizuesi me Shërbim Universal gjatë aplikimit për parametra rregulativ ka argumentuar se sistemi aktual i faturimit është i trashëguar dhe nuk përmbush standardet e fundit të menaxhimit të të dhënave dhe praktikat më të mira. FSHU operon me një program faturimi dhe menaxhimi të konsumatorëve të zhvilluar në vitin 2002, i cili nuk mund të përballojë rritjen e numrit të konsumatorëve dhe avancimin e shërbimeve digjitale. Vetëm pas privatizimit të kompanisë në vitin 2013, numri i konsumatorëve është dyfishuar, duke arritur mbi 730,000 konsumatorë, gjë që ka rritur ndjeshëm kompleksitetin dhe nevojat operative. Për më tepër, programi aktual nuk mbështet integrimin e plotë me sistemet e tjera moderne si SAP-i i implementuar së fundi në departamentin e financave, i cili është jetik për menaxhimin financiar dhe operativ të kompanisë.

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 9 prej 12
		Versioni	1.0

Përditësimi i sistemit të faturimit dhe menaxhimit të konsumatorëve është i domosdoshëm për të siguruar efikasitet, shmangien e mundshme të gabimeve dhe rritje të transparencës në shërbimet ndaj konsumatorëve. Njëkohësisht, ai do të ishte në hap me ndryshimet që po ndodhin në sektorin e energjisë, si hapja e tregut, funksionalizimi i mekanizmit balancues dhe operimi i konsumatorëve prodhues, të cilat kërkojnë një nivel më të lartë fleksibiliteti dhe menaxhimi në sistemin e faturimit. Mos-investimi në përditësimin e sistemit të faturimit dhe menaxhimit të konsumatorëve mund të sjellë pasoja serioze, si: rritja e ngarkesës së sistemit ekzistues, e cila po krijon vonesa në përpunim dhe rrezikon të ndërpres funksionimin nëse vazhdon me këtë rritje të ngarkesës. Pamundësia e zhvillimit të mëtutjeshëm dhe integritet me sisteme tjera, duke krijuar barriera operative, ka rrezik më të madh nga sulmet e avancuara kibernetike, si dhe pamundësohet integrimi i zhvillimeve të reja të tregut siç janë prosumatorët.


Duke marrë parasysh rëndësinë kyçe të këtyre investimeve për sigurimin e operimit të qëndrueshëm dhe efikas të FSHU-së gjatë periudhës së ardhshme rregullative, është e nevojshme që këto investime të mbështeten dhe të realizohen me prioritet. FSHU, duke u bazuar në analizat dhe nevojat e identifikuara për periudhën që vjen, përsërit kërkesën për aprovimin e këtyre investimeve nga ZRRE.

Është e rëndësishme të theksohet se njohja e këtij investimi është i domosdoshëm për një periudhë 3 vjeçare, për aq sa është paraparë zbatimi i programit deri në lansimin e tij në 3 muhorin e parë të vitit 2027. Detajet lidhur me projeksionet kohore, përfitimet dhe kostot e projektit i janë dorëzuar ZRRE-së si dokumente mbështetëse gjatë shqyrtimit të vlerave hyrëse.

FSHU përveç investimit në programin e faturimit, kërkon gjithashtu njohjen e investimeve përcjellëse që lidhen drejtpërdrejt me licencën e funksionimit të këtij programi në vazhdimësi, duke përfshirë mirëmbajtjen dhe përshtatjet teknike të nevojshme për të siguruar funksionalitetin e tij të pandërprerë. Po ashtu, investimet e zakonshme si licencat e sistemit operativ, kompjuterët dhe pajisjet e tjera për zyrë përbëjnë një pjesë historike të investimeve të kompanisë dhe janë të domosdoshme për operimin e saj. Për këtë arsye, këto investime duhet të njihen nga ZRRE si elemente esenciale për përmbushjen e detyrimeve operative dhe ofrimin e shërbimeve të pandërprera për konsumatorët.

Marrë parasysh të lartë thënat, është e domosdoshme që në vitet e ardhshme të lejohet një buxhet më i lartë për të mundësuar zhvillimin dhe implementimin e një sistemi të ri të faturimit. Tabela e mëposhtme paraqet kërkesën e FSHU-së për investimet e nevojshme në 3 vitet e ardhshme, ku për qëllime të këtij aplikimi, në kërkesën për të hyrat e lejuara maksimale është përdorur kërkesa e FSHU për vitin 2025 sipas normave të zhvlerësimit të aprovuara nga ZRRE në mbledhjen e parë të bordit për vitin 2025 .

në '000 €	2025	2026	2027
Buxheti i kërkuar (2025-2027)	2,308	3,573	2,749

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
		Faqe	Faqe 10 prej 12
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Versioni	1.0

Këto investime janë jetike për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të FSHU-së dhe për të përmbushur pritshmëritë në rritje të konsumatorëve. Implementimi i tyre do të mundësojë përmirësimin e ndjeshëm të shërbimeve, ndërkohë që do të zvogëlojë rreziqet e operimit me një sistem të vjetërsuar. Përfitimet e investimeve të propozuara tejkalojnë kostot e tyre, duke e bërë këtë një hap të domosdoshëm për të ardhmen e kompanisë dhe të konsumatorëve të saj.

#### 4. Kostot e bartshme

Konform nenit 18 të Rregullës për të Hyrat e FSHU-së, gjatë përcaktimit të MAR-it, FSHU do të mbulojë kostot e mëposhtme:

- Kostot e OT që faturohen nga OT dhe kanë të bëjnë me Konsumatorët e FSHU-së;
- Kostot e OS të cilat faturohen nga OS dhe ndërlidhen me Konsumatorët e FSHU-së;
- Kostot e SHST (TUOS) që faturohen nga OST dhe ndërlidhen me Konsumatorët e FSHU-së;
- Kostot për përdorimin e sistemit të shpërndarjes që faturohen nga OSSH dhe lidhen me Konsumatorët e FSHU-së.


Për më tepër, përveç kostove të sipërpërmendura OT faturon FSHU-në edhe për fondin BRE, i cili do të përfshihet si pjesë e kostove të bartshme.

Ndërkohë, bazuar në Rregullën për të Hyrat e FSHU-së, meqë, nuk ka dallime në afatet kohore kur të licencuarit e tjerë paraqesin aplikimet e tyre, FSHU do të përdorë informacionet që janë në dispozicion deri në kohën e dorëzimit të këtij aplikimi, respektivisht do të aplikojë çmimet aktuale në konsumin e parashikuar për kalkulimin e këtyre kostove gjatë kërkesës për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2025. Çdo ndryshim nga ZRRE gjatë përcaktimit të tarifave për OSSH dhe OST duhet të pasqyrohet në MAR-in përfundimtar për Furnizuesin me Shërbim Universal.

#### 5. Përshtatjet dhe Faktori korrigjues i të hyrave

Gjatë vitit 2024, furnizuesi është përballur me sfida të konsiderueshme për shkak të rritjes së ndjeshme të konsumit dhe prodhimit të ulët vendor. Për të përmbushur kërkesat e tregut, janë importuar shtesë 168 GWh energji elektrike me një kosto totale prej 47.8 milionë euro, nga të cilat 35.6 milionë euro janë realizuar vetëm në tre muajt e fundit të vitit. Kjo ka shkaktuar një tejkallim të kostove të lejuara prej 39.51 milionë euro neto, duke krijuar një ndikim të rëndësishëm financiar.

Në pajtim me Rregullën për të Hyrat e FSHU-së është bërë korrigjimi i të hyrave të vitit 2024, respektivisht FSHU ka llogaritur MAR-in aktual dhe të hyrat e realizuara gjatë vitit 2024. Sipas

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 11 prej 12
		Versioni	1.0


kalkulimeve faktori korigjues ka rezultuar të jetë 42.24 milion € (përfshirë normën e interesit) e cila është përshtatur në MAR-in e vitit 2025.

Përshkrimi	mil €
<b>MAR-i i Aprovuar</b>	<b>399.62</b>
<b>MAR-i Aktual</b>	<b>451.35</b>
Shitjet aktuale	411.81
Ndryshimi	39.51
It	6.91%
<b>Faktori korigjues i të hyrave (ADJt)</b>	<b>42.24</b>

Duhet theksuar se ndryshimi më i madhe në MAR-in aktual të vitit 2024 nga ai i aprovuar është për shkak të vlerës më të lartë në koston e importit me atë të parashikuar gjatë përcaktimit të MAR-it për vitin 2024. Kjo ka rezultuar veçanërisht e dukshme në muajt e fundit të vitit 2024, kur konsumi i energjisë elektrike ka pësuar rritje të konsiderueshme, ndërkohë që prodhimi vendor ka qenë në nivele më të ulëta se parashikimet për 80 MWh. Si rrjedhojë, furnizuesi i shërbimit universal është detyruar të importojë sasi shtesë të energjisë elektrike, duke shkaktuar tejkallim të kostove të lejuara. Përballja me këto sfida ka ndikuar në qëndrueshmërinë financiare të furnizuesit dhe ka vënë në pah rëndësinë e parashikimeve më të sakta për vitet e ardhshme.

Mosnjohja në kohë e kostove të realizuara ka shkaktuar sfida të mëdha për furnizuesin, duke përfshirë reduktimin e kapaciteteve financiare operative dhe vështirësimin e përballimit të investimeve dhe operacioneve të përditshme. Presioni për të siguruar burime shtesë financimi ka ndikuar negativisht në stabilitetin financiar dhe planifikimin afatgjatë, ndërsa konsumatorët janë përballur me sinjale të pasakta mbi kursimin dhe menaxhimin e konsumit. Për më tepër, furnizuesi është detyruar të mbulojë diferencën e kostove përmes financimeve shtesë, duke rritur varësinë nga burimet e tjera financiare.

Parashikimi i saktë i kostove mbetet domosdoshmëri për të ruajtur stabilitetin e furnizuesit dhe për të dërguar sinjale të sakta te konsumatorët për kursim të energjisë elektrike dhe zgjedhjen e alternativave për ngrohje. Është e rëndësishme të theksohet se për të katërtin vit radhazi, duke filluar që nga viti 2020, FSHU operon me pambulueshmëri të kostove gjatë përcaktimit të të hyrave të lejuara maksimale, e cila ka reflektuar me korigjim pozitiv vazhdimisht, barrë financiare kjo e bartur nga i licencuari nga viti në vit. Është faktike që KEK-Gjenerimi operon me njësitë gjeneruese të njëjta dhe pa ndonjë rehabilitim të konsiderueshëm i cili do të ndikonte pozitivisht në disponueshmërinë e njërive gjeneruese, por edhe për sasinë e prodhimit të energjisë elektrike. Prandaj, aplikimi i drejtë i kostove i mundëson Furnizuesit operim të qëndrueshëm por njëkohësisht edhe kosto më e ultë për konsumatorin fundor, i cili paguan interes shtesë për çdo kosto të tejkalluar gjatë vitit aktual

	NJËSIA PËR TARIFA DHE ÇËSHTJE RREGULLATIVE	Nr.	KESCO-BCC-F-BCT-02
	APLIKIMI PËR TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	Faqe	Faqe 12 prej 12
		Versioni	1.0

## 6. Të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2025

Duke marrë parasysh argumentet e prezantuara më lartë dhe në përputhje me Rregullën për të Hyrat e FSHU-së, kërkesa për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2025 është 448.14 mil €, siç është prezantuar në tabelën e mëposhtme:

Të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2025	mil€
It	6.91%
Kostot me pakicë	7.11
<i>OPMCt</i>	6.75
<i>DEPCt</i>	0.36
Kostot e bartshme (PSTCt)	168.43
Kostot e OST	35.35
Kostot e OSSH	117.67
Fondi BRE	15.41
Kostot e kapitalit punues (WCLCt)	2.28
Kostot e energjisë me shumicë (WHPC)	220.02
WHPC	214.57
Margjina me pakicë	5.45
Faktori i përshtatjeve të të hyrave (ADJ)	42.24
BDTA	8.07
<b>MAR</b>	<b>448.14</b>

Përcaktuesit e faturimit për vitin 2025 janë bazuar në vëllimet e shitjeve të parashikuara në draft bilancin e energjisë elektrike për vitin 2025. Me aplikimin e tarifave aktuale mbi përcaktuesit e faturimit të parashikuar për vitin 2025, priten të hyra të faturuara në vlerë prej 409.53 milion €, përderisa kostot e nevojshme për operim të duhur për vitin 2025 janë 448.14 milion €.

Kërkesa e FSHU-së për MAR-in e vitit 2025, paraqet kostot e nevojshme me qëllim të operimit të qëndrueshëm të Furnizuesit me shërbim universal. Njohja e kostove të realizuara dhe reflektimi i tyre në tarifën e ardhshme është e domosdoshme për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të furnizuesit dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve. Për më tepër, përmirësimi i proceseve të parashikimit është thelbësor për të shmangur rreziqet financiare në të ardhmen dhe për të siguruar një shërbim të qëndrueshëm dhe të besueshëm për të gjithë konsumatorët. Furnizuesi duhet të ketë në dispozicion mjete të avancuara për modelimin e kostove dhe të sigurojë një bashkëpunim të ngushtë me institucionet rregullative për të garantuar një qasje transparente dhe të përgjegjshme.